



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 2268 Prot.

Vlorë, më 02/07/2018

VENDIM

Nr. 24, datë 27.06.2018

PROPOZIM PËR PËRFITIM PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 27.06.2018 në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore“, nenit 5 të Ligjit Nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, pikës 4 dhe 5 të VKM - së Nr.429, datë 12.09.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore” si dhe kërkesës së Z. Uran XHAFA për përfitim pensioni të posaçëm shtetëror,

VENDOSI;

- 1.Ti propozojë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhënien e Pensionit të Posaçëm Shtetëror **Z. Uran Remzi XHAFA**, për kontributin e dhënë në zhvillimin dhe përhapjen e sportit të futbollit, si dhe për rezultatet e arritura në veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari, Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve pranë Këshillit të Qarkut Vlorë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.



Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me Nr. \_\_\_\_\_ Prot, datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2018.

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë  
Sheshi “ 4 Heronjtë ”, Vlorë  
Vlorë (AL)

Web site: [www.qarkuvlore.gov.al](http://www.qarkuvlore.gov.al)  
E-mail: [info@qarkuvlore.gov](mailto:info@qarkuvlore.gov)  
Tel: +355 33 421 600



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT VLORË

RELACION

**Të Nderuar Këshilltarë!**

Në bazë të nenit 5 të Ligjit Nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë“, i ndryshuar si dhe pikës 4 e 5 të VKM - së Nr.429, datë 12.09.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore”, pensionin e posaçëm shtetëror e përfitojnë ata persona që:

- a) Kanë marrë pjesë në lëvizjen e Rilindjes Kombëtare, në lëvizjet popullore, në luftën kundër pushtuesve nazifashistë brenda dhe jashtë Shqipërisë, në mbrojtjen e kufirit e ruajtjen e integritetit territorial të Shqipërisë, në lëvizjen demokratike dhe që kanë merita të veçanta;
- b) Kanë arritur rezultate të dallueshme në fushën e shkencës, kulturës, arteve, ekonomisë dhe politikës;
- c) Kanë vuajtur nga persekutimi politik nën regjimin komunist.

Pensionin e Posaçëm Shtetëror e përfitojnë personat të cilët përmbushin kushtet e sipërpërmendura si shtesë mbi pensionin që u takon nga Sigurimet Shoqërore, ose si pension nëse nuk përfitojnë pension nga Sigurimet Shoqërore.

Në mbështetje të bazës ligjore të sipërpërmendur z. Uran Remzi Xhafa i lindur më 24.08.1951 në Kaninë, Vlorë dhe banues në Vlorë ka paraqitur kërkesë pranë institucionit të Këshillit të Qarkut Vlorë për përfitim pensioni të posaçëm shtetëror.

Kërkesa drejtuar Këshillit të Qarkut Vlorë mbështetet në kontributin e dhënë në zhvillimin dhe përhapjen e sportit të futbollit, si dhe rezultatet e arritura në veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare. Për aktivitetin e ngjeshur sportiv, energjinë, lojën, dashurinë për futbollin dhe titujt e fituar nga z. Xhafa janë shkruar shumë artikuj dhe realizuar disa krinika sportive. Gjithashtu z. Xhafa ka kontribuar edhe në përgatitjen dhe stërvitjen e brezit të ri duke përcjell dashurinë për sportin e futbollit.

Bashkalidhur kërkesës gjendet dokumentacioni i mëposhtëm:

- CV e z.Uran Xhafa,
- Çertifikatë familjare (format elektronik) më datë 18.06.2018,
- Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Nr. 2425 prot, datë 07.05.2018,

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë  
Sheshi " 4 Heronjtë ", Vlorë  
Vlorë (AL)

Web site: [www.qarkuvlore.gov.al](http://www.qarkuvlore.gov.al)  
E-mail: [info@qarkuvlore.gov](mailto:info@qarkuvlore.gov).  
Tel: +355 33 421 600





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT VLORË

- Fotokopje e kartës së identitetit,
- Shkrim në gazetën “Telegraf”.

Kopje të noterizuara të Titujve:

- Çertifikatë **“Mjeshtër sporti”**, dhënë nga Bashkimi i Fiskulturistëve e Sportistëve të Shqipërisë, më 21.11.1980.
- Fletë nderi **“Mjeshtër i sportit, figurë e shquar e futbollit vlonjat”**. Gjatë gjithë karrierës së tij futbollistike, në ndeshje kombëtare dhe ndërkombëtare është karakterizuar nga vullneti i hekurt, forcë dhe luftë e pastër sportive. Me pasionin për futbollin dhe pjekurinë e tij ka kontribuar në ngritjen e nivelit të futbollit vlonjat duke i dhënë atij ngjyra burrërore dhe luftarake”, dhënë nga Komiteti i BFSSH, Kryesia e Klubit “Flamurtari”, më 15.02.1985.
- Medalje e Artë **“Për merita në fushën e sportit”**, dhënë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve me motivacion “Për kontributin e dhënë në zhvillimin dhe përhapjen e sportit të futbollit, si dhe për rezultatet e arritura në veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare”.
- Titulli **“Mjeshtër i madh”** dhënë nga Presidenti i Republikës me Nr. Dekreti 10523, datë 21.06.2017 me motivacion “Për kontributin dhe vlerat e paraqitura në sportin e futbollit si lojtar i skuadrës së “Flamurtarit”, “Partizanit” dhe ekipit kombëtar, por edhe si trajner dhe specialist i mirënjohur në përgatitjen e brezave të futbollit vlonjat”.
- Titulli **“Legjenda e futbollit shqiptar”** dhënë nga Federata Shqiptare e Futbollit me motivacion “Një nga emblemat e futbollit vlonjat në vitet 1970-1980. Anëtar i ekipit kombëtar të futbollit me të cilin ka spikatur në disa takime të rëndësishme”, Tiranë 2017.

*Duke u bazuar në kërkesën e z. Uran XHAFJA, në zbatim të Ligjit Nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të pikës 4 dhe 5 të VKM- së Nr. 429 datë 12.09.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore”, mendojmë se personi i propozuar i plotëson kushtet për të përfituar këtë lloj pensioni.*

Jurist

Alma MYRTAJ